

L I G J
Nr.8070, datë 15.2.1996

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR TATIMIN MBI VLERËN
E SHTUAR”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 60 i ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, ndryshohet si vijon:
“Ky ligj hyn në fuqi menjëherë. Zbatimi i TVSH-së dhe zëvendësimi i tatimit mbi qarkullimin fillon në gjashtëmujorin e dytë të vitit 1996. Data e saktë e fillimit të zbatimit të këtij tatimi caktohet nga Këshilli i Ministrave. Me fillimin e zbatimit të TVSH-së, ligji nr.7676, datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi qarkullimin” si dhe çdo dispozitë tjetër e lidhur me të, shfuqizohen.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1389, datë 29.2.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha